



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 148/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Prizren, për shkak të vendosjes së posterit në vende publike, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.10.2017, mori këtë:

### VENDIM

**KONSTATOHET** tërheqja e ankesës e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ZL. A.nr. 148/2017 të datës 09.10.2017.

### Arsyetim

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka paraqitur ankesë në PZAP kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), për shkak të vendosjes së posterit të Kandidatit Xhavit Ukaj për Anëtar të Kuvendit Komunal në Prizren nga radhët e subjektit politik LDK, në lagjen “Ortakoll” pra në trafon elektrike në Prizren, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen më 22 tetor 2017.

Me datë 10.10.2017, ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesë me numër: Anr.148/5 të datës 10.10.2017.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP -së, PZAP -i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa**  
Anr.148/2017 më datën 10.10.2017



**Kryesues i Panelit**  
**Zyhdi Haziri**